



Datë: 09.06.2025

Numër Protokolli: 4659/2025

A.nr.374/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.374/2025 të datës 27.02.2025, të parashtruar nga ankuesi N.G, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Agim Rexhaj, kundër organit të punësimit/Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.06.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.374/2025 e datës 27.02.2025 e parashtruar nga ankuesi N.G.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 125 i datës 31.01.2025, i Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil N.G (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi*), më datë 27.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1301/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 125 të datës 31.01.2025, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.03.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 26.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1301/2025 të datës 27.02.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Autorizimin e datës 11.02.2025; Vendimin me numër protokolli me numër 125, të datës 31.01.2025;

Formën e caktimit fillestar të punëdhënësit kryesor të datës 14.05.2002; Librezë e punës me nr.serik 54732; Vërtetim nga "Liria Commerce"; Profili nga SIMBNJ i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.03.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 26.03.2025; Akt emërimit me numër protokolli 118 të datës 28.12.2017; Certifikatën e regjistrimit me nr.70541238; Informatën mbi biznesin; Vërtetimin e datës 01.09.2004; Deklaratën nën betim të datës 04.06.2015; Pasqyrën e llogarisë së trustit; Deklaratën e datës 04.11.2024; E-mailin e datës 21.06.2024; E-mailin e datës 24.06.2024; E-mailin e datës 03.10.2024, me korrespondim prej 4 faqeve; E-mailin e datës 05.08.2024; E-mailin e datës 14.06.2024; E-mailin e datës 20.06.2024; Pasqyrat tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuale e datës 15.07.2009 (TM1/2009, TM2/2009, TM3/2009; E-mailin e datës 26.06.2024; E-mailin e datës 04.07.2024; E-mailin e datës 24.07.2024; E-mailin e datës 02.10.2024, me korrespondim prej 5 faqeve; E-mailin e datës 16.10.2024; E-mailin e datës 14.10.2024; E-mailin e datës 11.10.2024; Mirënjohje; E-mailin e datës 14.10.2024; E-mailin e datës 15.10.2024; E-mailin e datës 16.10.2024; E-mailin e datës 17.10.2024; E-mailat e datës 24.10.2024; E-mailin e datës 25.10.2024; E-mailin e datës 28.10.2024; E-mailin e datës 31.10.2024, me korrespondim prej 5 faqeve; E-mailat e datës 01.11.2024; E-mailin e datës 04.11.2024, me korrespondim prej 4 faqeve; E-mailin e datës 29.11.2024; E-mailin e datës 02.12.2024, me korrespondim prej 3 faqeve; E-mailin e datës 05.11.2024; Protokollin dhe shkresat në gjuhën serbe; E-mailin e datës 14.11.2024, me korrespondim prej 3 faqeve; E-mailin e datës 15.11.2024, me korrespondim prej 3 faqeve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokolli 118 të datës 28.12.2017, është i punësuar në pozitën e punës *Udhëheqës i Zyrës së Punësimit në Ferizaj*, në kuadër të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Tutje sipas shkresave të lëndës rrjedhë se me Vendimin me numër protokolli 125 të datës 31.01.2025, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, ankuesit i është njohur përvoja e punës prej njëzet (20) vite e tre (3) muaj, ndërsa si dokumente që nuk përmbushin kriteret ligjore lidhur me njohjen e përvojës së punës ankuesit i janë refuzuar: Forma e caktimit fillestar të punëdhënësit kryesor të datës 14.05.2002; Librezë e punës me nr.serik 54732; Vërtetimi nga NTP Lirija Commerce e datës 01.09.2004.

Ankuesi, kundër Vendimit me numër protokolli 125 të datës 31.01.2025, të Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, për shkak të mungesës së një verifikimi të plotë dhe të detajuar, trajtimit të pabarabartë dhe shkelje e parimit të barazisë, duke i propozuar Këshillit, aprovimin e ankesës, anulimin e aktit kontestues, me detyrimin që organi i punësimit t'ia njohë të njëjtit edhe përvojën e punës nga data 01.08.1991 deri më 20.03.1999, dhe nga data 01.02.2002-30.06.2003 (9 vite e 19 ditësh) dhe në tërësi prej njëzet e nëntë viteve (29), tre muaj (3) muaj e nëntëmbëdhjetë (19) ditëve përvojë pune.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, i'u referua Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, përkatësisht Nenit 1, ku përcaktohet se: *Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për llogaritjen e pagës dhe të përvojës në punë, për të punësuarit në sektorin publik.*; dhe Nenit 6, ku përcaktohet se: *1. Përvoja e punës llogaritet mbi pagën bazë, në masën: 1.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 1.2. zero pikë*

pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë. 2. Përvoja e punës dëshmohet përmes njërës prej dëshmive si vijon: 2.1.1.dëshmive të ofruara nga njësia përkatëse e pensione në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensione; 2.1.2.librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar); 2.1.3.dëshmisë që vërteton se i ka paguar kontributet ai dhe/ose punëdhënësi ku ka punuar; dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e njësive përkatëse të pensione në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensione, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989; 2.1.4.regjistrin të pagave; 2.1.5.kartelës së pagave; 2.1.6.vendimit apo kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës; 2.1.7.formularit për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (M1,M-2); 2.1.8.vendimit për pagën, rritje dhe harmonizim; 2.1.9.vendimit për pushimin vjetor; 2.1.10. vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 2.1.11. vendimit në origjinal të ish Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës; 2.1.12. vërtetimit nga Agjencia Kosovare për Privatizim, për stazhin e punës në ndërmarrjet shoqërore; 2.1.13. dëshmisë-çertifikatës për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal në rastin e zejtarëve privat; 2.1.14. vërtetimit të lëshuar në origjinal nga kompania private me vulë dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim. 2.2. pas qershorit 1999: 2.2.1. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga njësia kompetente për menaxhimin e personelit në Institucionet e Republikës së Kosovës ose nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë; 2.2.2. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga ndërmarrjet publike ose nga ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë qenë ose janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim; 2.2.3. dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin; 2.2.4. dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent; 2.2.5. dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i një shteti të huaj në të cilin punëtori ka punuar; 2.2.6. çdo dëshmie tjetër të vërtetuar në procedurë gjyqësore përmes aktgjykimit të plotfuqishëm; 2.2.7. dëshmi tjetër plotësuese mund të konsiderohet edhe lista e pagave. 3. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore në çdo institucion, në pajtim me këtë rregullore, vendosë për njohjen e përvojës së punës së një nëpunësi i cili merr pagë nga buxheti i Kosovës. Vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin i punësuar dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të lartë theksuar dhe shkresat e bashkangjitura të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Punësimit e Republikës së Kosovës, me rastin e vendimmarrjes së çështjes për verifikimin, krahasimin dhe vlerësimin e dokumenteve të bashkangjitura nga ankuesi, ka bashkëpunuar me organet kompetente të fushës përkatëse, gjegjësisht Departamentin e Pensioneve në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Zyrën e Pensioneve në Ferizaj dhe Fondin e Kursimeve Pensionale, si rrjedhojë me rastin e refuzimit të dokumenteve që nuk përmbushin kriteret ligjore lidhur me njohjen e përvojës së punës ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, ngase Librezës së punës me nr.serik 54732 i mungon numri amëz i të siguruarit, element i paraparë në dispozitat e lartë theksuara ligjore, dhe se e njëjta fillimisht është dërguar e hapur e pa vulosur dhe e pa nënshkruar në rubrikën e datës së mbylljes, ndërsa, më datë 29.10.2024 është dërguar po e njëjta librezë, mirëpo tanimë rezulton e mbyllur, e nënshkruar dhe vulosur, duke krijuar kështu dy versione kontradiktore për të njëjtin dokument, si dhe po ashtu, nga shkresat e lëndës rezulton e njëjta gjendje faktike edhe tek dokumentet tjera ngase kemi mos përputhje në datat e fillimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës, sikurse tek Libreza e punës (nga data 01.08.1991-20.03.1999); Vërtetimi i punëdhënësit (nga data 01.06.1991-31.05.2001), Deklarata nën betim e punëdhënësit (nga data 01.06.1991 deri më 30.05.2001) si dhe tek Formulari M1 rezulton një gabim i dukshëm kronologjik ngase data e fillimit të punës është përcaktuar 20.03.1999 ndërsa data e mbarimit 01.08.1991, duke shtuar dyshime mbi autenticitetin dhe vërtetësinë e tij, si rrjedhojë i njëjti përveç se është i pa vlefshëm rrit edhe më tepër dyshimin mbi origjinalitetin me dokumentet tjera.

Theksuar si me lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstaton se mos përputhjet serioze në përmbajtjen formën dhe kronologjinë e dokumenteve, mungesës së elementeve të domosdoshme për vlefshmëri, si dhe dyshimet mbi vërtetësinë e disa nga provave, përbëjnë bazë të mjaftueshme për konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa qëndrueshëm, ndaj duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht të refuzoj ankesën e ankuesit si të pa bazuar, ndërsa të mbetet në fuqi me numër protokolli 125 të datës 31.01.2025, të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, ku ankuesit i është njohur përvoja e punës prej njëzet (20) vite e tre (3) muaj, pasi që me rastin e trajtimit të kërkesës së ankuesit, organi përkatës i punësimit ka zbatuar drejtë dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik dhe po ashtu ka konstatuar saktë gjendjen faktike.

Bazuar në atë që u tha si më lartë dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.374/2025

Atdhe Gashi

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Agim Rexhaj;
- Agjencisë së Punësimit (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.